Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Republika e Kosovës- Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Zyra e Drejtorit/ Kancelaria Direktora /Office of the Director

Numër: 02-594
Datë: 22.12.2016

Bazuar në nenin 142, me të gjitha pikat të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikime Kombëtare, nenin 17 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dt. 22.03.2011, nenin 11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 18 me të gjitha dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Drejtori i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), nxjerrë:

V E N D I M

Kthimin e mjeteve të pagesave të institucioneve aplikuese në procesin e validimit dhe akreditimit dhe ri-akreditimit sipas kalkulimit te shpenzimeve të proceseve për institucionet si në vijim;

1. Akademia jCoders- 450€

A r s y e t i m i

Duke u bazuar ne kerkesen me nr.585 te dates 21.12.2016 nga institucioni Akademia jCoders në përputhje me nenin 18 mbi Taksat dhe Pagesat, nga pika 1 deri 11 te U.A. 35/2014-Kriteret dhe Procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime ne Kosovë u lejohet kthimi i mjeteve duket u bazuar si ne dispozitiv.

1. Akademisë jCoder u jan kalkuluar shpenzimet e procesit te validimit dhe akreditimit me nje lokacion shtese dhe ne realitet i njëjti institucion nuk e posedon ate lokacion.

Me ketë rast AKK ka llogaritur shpenzimet për një lokacion shtese qe janë 250€ dhe shpenzimet e eksperteve te panelit qe janë 200€.

Vendimi u dërgohet:

1. Ministra e Financave-Thesari;
2. Zyrës së Drejtorit të AKK;
3. Arkivit.

Avni Gashi,
u.d. i Drejtorit të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve